L I G J
Nr.7984, datë 28.7.1995

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.7941, DATË 31.5.1995 "PËR HYRJEN NË FUQI TË LIGJIT NR.7895, DATË 27.1.1995" "PËR KODIN PENAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491 datë 29.4.1991, "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 2 ndryshohet si vijon:

Personat të cilët janë dënuar me vendim të formës së prerë për një ose më shumë vepra penale me masa dënimi për një ose më shumë prej tyre më të larta se sa maksimumi që parashikon për to Kodi i ri Penal, ju mbetet për secilën prej tyre ky maksimum.

I njëjti dënim i formës së prerë mbetet edhe kur neni përkatës i Kodit të Ri Penal e parashikon atë masë dënimi.

Personat të cilët pas hyrjes në fuqi të Kodit të Ri Penal e kanë plotësuar dënimin e parashikuar për veprat sipas Kodit të Ri Penal, në përputhje me këtë ligj, lirohen menjëherë.

Neni 2

Në nenin 8 shtohet paragrafi i mëposhtëm:

Kur një person ka kryer një ose më shumë vepra penale për të cilat, sipas këtij ligji, nuk u ndryshohet masa e dënimit të dhënë me vendim të formës së prerë, mbetet bashkimi i dënimeve i bërë në atë vendim të formës së prerë.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi më datën 28 korrik 1995.

Shpallur me dekretin nr.1171, datë 3.8.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha